

VENDIM
Nr. 11, datë 17.4.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 43, DATË 8.11.2024, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME VLORË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 17.4.2025, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 43, datë 8.11.2024, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë’”

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. 831 prot., datë 20.3.2025, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor .

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë, me vendimin nr. 43, datë 8.11.2024, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë, z. Ermal Murati, ka përfunduar studimet e larta për Menaxhim Biznesi, Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë në vitin 2001.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit të KKRR-së nr. 43, datë 8.11.2024, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Vlorë sh.a.” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Ermal Murati”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja